



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assambly of Rahovec



	REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KUVENDI I KOMUNES/SKUPSTINA OPSTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY	
RAHOVEC /ORAHOVAC		
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)		
Nr./Br./No <u>01/62</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>80</u>		
Data/Datën/Data <u>30</u> / <u>06</u> / <u>2025</u>		

Raporti nga procesi i organizimit të konsultimit publik për KAB me anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa për projekt - buxhetin e komunës për vitin 2026

Qershor 2025

Hyrje

Bazuar në ligjin për Qeverisje Lokale, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017 si dhe Udhëzimin Administrativ për Administratë (MAPL) Nr. 04/2023 të Hapur në Komuna, Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa nga kuvendi i komunës së Rahovecit kanë planifikuar organizimin e konsultimit publik për KAB me datën 20.6.2025. Me datë 8.7.2024 Kryetari i Komunës Smajl Latifi me vendimin Nr: 4422 ka caktuar grupin punës i cili sipas UA Nr. 04/2023 ka organizuar dëgjimet dhe ka adresuar kërkesat e pranuar nga qytetarët në dëgjimet buxhetore.

Zyra për informim e ka bërë njoftimin sa i përket organizimit të konsultimit publik për KAB të organizuar nga anëtarët e KPF-së, ku e ka bashkëngjitur në linkun <https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Njoftim-per-konsultim-publik-per-KAB-nga-KPF.pdf>

Ftesat dhe njoftimet për mbajtjen e dëgjimit buxhetor janë shpërndarë me kohë (14 ditë) para mbajtjes së dëgjimit, poashtu ftesat ju janë dërguar në email anëtarëve të KPF-së dhe anëtarëve të kuvendit. Gjithashtu njoftimi është shpërndarë me kohë në rrjetet sociale zyrtare të komunës.

Disa nga anëtarët e KPF-së, anëtarët e kuvendit dhe grupi punës kanë qenë pjesëmarrës në këtë takim, por, **për shkak të mospjesëmarrjes së qytetarëve, ky konsultim publik për KAB i organizuar nga anëtarët e KPF-së, ka dështuar, të bashkëngjitur e gjeni lajmin për mbajtje të dëgjimit buxhetor.**

Poashtu personat përgjegjës të cekur në njoftim nuk kanë pranuar asnjë kërkesë në emailat e tyre.

Skender Hamza
